

BEDRI MUHADRI**KOSOVA NË KUADRIN E PRINCIPATËS SË BALSHAJVE****Historia dhe gjenealogjia e Balshajve**

Në vitin 1371, me rënien e mbizotërimit sundues të serbëve në trojet arbërore, u krijuan formacione politike të rëndësishme nga fisnikët arbër (shqiptarë) në trevat ku zotërohen nga ata. Kështu në trevat arbërore në veri u formua principata e Balshajve me qendër qytetin e Shkodrës. Principata e Balshajve bëhet formacion shtetëror feudal me rol të rëndësishëm politik në trojet e Arbërisë së Epërme në fillim të viteve 60-të të shek. XIV. Territori mbi të cilën shtrihej pushteti i Balshajve i fillimviteve 60-të të shek. XIV emërtohej nga vetë Balshajt, ose nga të huajt, Zetë* që rrjedh sipas një lumi me emër Zetë, degë e lumit Moraça.¹ Me emrin Zetë nënkuptohet territori rreth lumit Zetë, nga i cili e merr emrin.² Zeta, si koncept gjeografik, gjatë shek. XIV ndahej në Zetën e Poshtme dhe në atë të Epërme. Zeta e Poshtme shtrihej përgjatë bregdetit Adriatik, nga Budua deri në Shën Shirgj mbi lumin Bunë, ndërsa Zeta e Epërme nga malet e Njegoshit mbi Kotorr e deri në lindje të liqenit të Shkodrës.³ Në vitin 1400, territoret deri në Kotorr përmenden brenda konceptit Arbëri.⁴ Në këtë kontekst është për të vënë re se, popullata arbërore gjatë gjithë Mesjetës dhe gjatë sundimit osman ka qenë e pranishme në pjesën lindore e jugore të Malit të Zi të sotëm, sa që edhe shkrimtarët e kohës, njerëz të oborrit mbretëror të Rashës, si K. Filozofi, bregdetin e Zetës e quanin trevë arbërore (арбансказемла).⁵ Ka të ngjarë

* Krahina e Dioklesë, në shek. XI, filloi të quhej Zetë.

¹ Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë: Rilindja, 1986, f. 115.

² Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, Tiranë: Botimet 55, 2009, f. 18.

³ Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët-Historia e shqiptarëve të veriut*, Tiranë: Bargjini, 2001, f. 111.

⁴ Qerim Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)*, Tetovë: ARS-ZZ, 2012, f. 47.

⁵ Gjon Berisha, *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shek XI – XV*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë: 2015, f. 248.

që emri Zeta, është me origjinë arbërore dhe e kanë përdorur të gjithë ata që, “*shohin te shqiptarët pasardhësit e vërtetë të Ilirëve të vjetër, të cilët ishin përhapur shumë në veri...*”⁶ Sipas Shuflajt, Zeta dhe Shqipëria e Veriut përfaqësonin një “*njësi biologjike të veçantë: ato i bashkonte e njëjta plastikë, i njëjti gjak ilir dhe e njëjta peripeci historike*”.⁷ Rrethanat objektive historike, që u krijuan pas vdekjes së Dushanit, pas më se 150 vjet nën sundimin e huaj nemanjid aktivizuan një familje feudale nga dinastia vendase arbërore e Balshajve, e cila do të qeverisi Zetën për rreth 61 vjet me radhë (1360-1421).⁸

Balshajt rridhnin nga një familje bujare arbërore, që përmendet në gjysmën e parë të shek. XIV. Balsha I ishte feudal i vogël që zotëronte një fshat (zotër të fshatit Balëz, me 350 bujq në lindje të liqenit të Shkodrës).⁹ Kjo familje në kuptimin etimologjik të mbiemrit lidhet me emrin e një qyteti mesjetar arbëror Balecium-Balleze.¹⁰ Për përkatësinë e tyre etnike janë shfaqur disa mendime, por që përfundimisht qëndrojnë pikëpamjet mbi përkatësinë arbërore të Balshajve.¹¹ Për përkatësinë

⁶ G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 19.

⁷ Gj. Berisha, *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore ...*, f. 249.

⁸ *Po aty*, f. 338.

⁹ Мавро Орбини, *Кралевство Словена*, Rpska Knjizevna Zadruga, Београд: 1968, f. 64.

¹⁰ Fan S. Noli, *Historia e Skënderbeut*, Boston: Shtypshkronja e “Diellit”, 1921, f. 23

¹¹ “*Balshajt ishin një ndër familjet e vogla bujare arbëreshe që përmenden në gjysmën e parë të shekullit XIV ...*”, (*Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Prishtinë: Enti i botimeve të teksteve të RS të Serbisë, Prishtinë: 1969, f. 210); “*Balshajt ishin në mesin e shekullit XIV, zotërues feudal në Shqipërinë e Mesme bregdetare dhe si bashkëluftëtarë të Skënderbeut*” (*Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë: 1985, f. 64); “*Balshajt janë me origjinë rumune dhe vllahë dhe e mbajnë veten shqiptarë, mbajnë kancelarinë serbe dhe e konsiderojnë veten si pronarë të perandorisë serbe*” (Dr. Milan Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë: Rilindja, 1968, f. 36). “*Balshajt ishin me prejardhje shqiptare, mirpo ishin të serbizuar në një shkallë të lartë, nga aspekti kulturor. Ata kanë qenë ortodoksë për një kohë të gjatë, ndërsa janë konvertuar në katolicizëm një apo dy herë për arsye politike*” (Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha Ditore, 2001, f. 386). “*Origjina e Balshajve nuk është e vërtetuar*” (Risto Kovijanić, “*Pomeni crnogorskih plemena u Kotorskim spomenicima*”, Istorijiski Institut SR Crne Gore, Titograd: 1974, f. 189-190). “*Ka të ngjarë se Balshajt rrjedhin nga vllahët e sllavizuar*” (*Istorija Crne Gore*, vol. II, Titograd: Red. za istoiju Crne Gore, 1970, f. 6-7). Për disa autorë Balshajt ishin serbë (Peter Barlt, *Shqipëria nga mesjeta deri më sot*, Prizren: Drita, 1999, f. 35). “*Prej farefisit të sundimtarëve Nemanjan doli Balsha I Plaku, thujse fare pranë qytetit deri në det*” (Marin Barleti, *Rrethimi i Shkodrës*,

arbërore të Balshajve shkruan edhe biografi i njohur bullgar i shek. XV, Konstandin Filozofi, që jetonte në oborrin e sundimtari serb, Stefan Lazareviqit. Ai i quan “*Gjergj Strazimir Balshën dhe Balshën III kryezotërinj arbërorë*”¹². Edhe burimet historike raguzane dëshmojnë për përkatësinë etnike arbërore të familjes Balsha. Kështu, raguzanët përmendin “*zakonet arbërore të Balshajve*”.¹³ Madje, Gjergji II Balsha u cilësua nga osmanët, “*sundimtar i Shkodrës arbërore*”.¹⁴ Mbreti hungarez Sigismundi, kur ky e takoi personalisht më 1396, e quajti “*sundimtar i Arbërisë*”¹⁵.

Një pinjoll i kësaj familjeje me emrin Balsha u shqua rreth mesit të shek. XIV si zhupan i ushtrisë së car Dushanit. Themeluesi i kësaj

Universiteti Shtetëror i Tiranës. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1967, f. 36). Për përkatësinë arbërore të Balshajve shkruan edhe biografi i njohur bullgar i shek. XV Konstandin Filozofi, që jetonte në oborrin e sundimtarit serb Stefan Lazareviqit. Ai i quan “*Gjergj Strazimir Balshën dhe Balshën III kryezotërinj arbërorë*” (Pranvera Bogdani, “Kosova në shtetin feudal shqiptar të Balshajve”, *E Vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1990, f. 111). Edhe burimet historike raguzane dëshmojnë për përkatësinë etnike arbërore të familjes Balsha. Kështu, raguzanët përmendin “*zakonet arbërore të Balshajve*” (Qerim Dalipi, *Inkursionet osmane në trevat Shqiptare deri më 1402*, Kërçovë: Feniks, 2002, 64). Kurse sipas historianit kritik serb I. Ruvarac, “*Balshajt në asnjë mënyrë nuk ishin serbë por arbërorë, pavarësisht nëse në origjinën e largët ishin arbërorë a vllahë*. (Илио Руварац, *О кнезу Ласару*, Нови Цад: 1887, f. 410). Madje, Gjergji II Balsha u cilësua nga osmanët, “*sundimtar i Shkodrës arbërore*” (*Lufta shqiptaro-turke në shek. XV – Burime Osmane*, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1968, f. 134, 296, (më tej: *Burime Osmane*). Kur perandori hungarez Sigismundi, takoi personalisht më 1396, mori titullin “*sundimtar i Arbërisë*”. Ludovicus de Thalloczy, Constantinus Jireček et Eemilianus de Sufflay, *Acta et diplomatares Albaniae mediae aetatis illustrantia, collegerunt et digeserunt*, vol. II, Vindobonae: 1918, dok. nr. 579, f. 161. Nga faktet e sjella shihet qartë se dëshmitë për përkatësinë arbërore të Balshajve janë më të argumentuara. Prandaj, tani më shumë studiues të huaj, dhe ata shqiptarë në tërësi me të drejtë i kanë cilësuar Balshajt arbër.

¹² P. Bogdani, “Kosova në shtetin feudal shqiptar të Balshajve ...”, f. 111.

¹³ Q. Dalipi, *Inkursionet osmane në trevat shqiptare deri më 1402 ...*, f. 64.

¹⁴ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, (Tiranë: 2002), f. 227; *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV ...*, f. 134, 296.

¹⁵ *Acta et Diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, volumen II (annos 1344-1406 continens), Vindobonae MCMXIII, përgatitur nga Dr. Ludovicus de Thalloczy, Dr. Constantinus Jireček, Dr. Emilianus de Sufflay. Botues Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, Tiranë & Revista Ekskluzive, Prishtinë, Tiranë-Prishtinë: 2002, dok. nr. 579, f. 161; M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, (Tiranë: 2002), f. 227.

dinastie, Balsha I (Plaku), ishte feudal i vogël që zotëronte vetëm një fshat.¹⁶ Për herë të parë, Balsha I (Plaku) përmendet në kronikat e kohës në vitin 1356, ku sulmoi dhe shkatërroi ushtrinë serbe të Uroshit V (të birit të Stefan Dushanit), të cilit i rrëmbeu shumicën e zotërimeve një vit pas vdekjes së perandorit Dushan, në vitin 1355. Zgjerimi i shpejtë i zotërimeve të Balshajve, pa dyshim ishte edhe si rezultat i sundimit të përbashkët të tre vëllezërve Balsha, nën udhëheqjen e babait të tyre, Balsha I, po edhe pas vdekjes së tij (1362). Vazhduesit e dinastisë së Balshajve, djemtë e Balshës I, tre vëllezërit Balsha, duke shfrytëzuar momentin e përshtatshëm pas rënies së Perandorisë Serbe¹⁷, iu vunë projektit për ta kthyer Gentën (Zetën) dhe Dioklenë, nën zotërimin e tyre duke e bërë të pavarur nga Mbretëria Serbe. Për këtë qëllim, ata prenë çdo lidhje me oborrin e carit të ri serb, Stefan Uroshit V, i cili i konsideronte Balshajt “rebel” dhe i trajtonte si kundërshtarë të papajtueshëm të tij. Vëllezërit Balsha (Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II) dalin në skenë si qeveritarë në Zetë që nga viti 1360, së pari në Budua (Budva e sotme), dhe Tivar. Më vonë, Balshajt do të arrijnë të zotëronin Ulqinin, Tivarin, skelën e Shirgjit dhe Shkodrën, e cila u bë kryeqendra e tyre dhe qyteti u bë qendër me ndikim të gjerë ekonomik, politik e kulturor në trojet arbërore.¹⁸ Gjatë vitit 1361, vëllezërit Balsha një vit më pas, në pranverë të vitit 1362, morën edhe qendrën ipeshkvnore të

¹⁶ Burimi i parë historik i cili e përmend udhëheqësin e Balshajve është Mavro Orbini. Sipas tij, Balsha I, gjatë kohës së sundimit të Stefan Dushanit (1331-1355), ishte një feudal i vogël që zotëronte vetëm një fshat. (Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane ...*, f. 47).

¹⁷ Më 1355 vdes car Dushani dhe me vdekjen e tij, Perandoria Serbe u dobësua dhe u nda në disa sundimtarë. Territori dhe pushteti perandorak që krijoi Car Dushani pësuan humbje të mëdha pas vdekjes së tij (1355). Mungesa e personalitetit i çliroi sundimtarët krahinorë prej pushtetit të tij qendror. Pasardhësi i Dushanit, perandor Uroshi i dobët, nuk arriti të pengojë shfaqjen e separatizmit të një varg i tërë feudalësh, të cilët sundonin gati të pavarur në krahinat e tyre. Kështu, nga germadhat e perandorisë së Car Dushanit, siç shkruan një kronist bizantin, u krijuan “disa mijëra copëra, të cilat u deklaruan të pavarura nën princat feudalë vendës” (Fan Noli, *Historia e Skënderbeut, kryezoti i Arbërisë*, Boston: botoi Federata Pan-Shqiptare “Vatra”, 1950, 7-8)

¹⁸ Pranvera Bogdani, *Balshajt - Lufta e Principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XV*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, 28,

Drishtit, ndërsa në vitin 1367 përfundimisht kishin nën zotërim edhe Budvën.¹⁹

Me këto zgjerime, Balshajt ishin në gjendje të kontrollonin lëvizjet tregtare nëpër Adriatik. Nën qeverisjen e tyre ndodheshin rrugët tregtare që shkonin prej bregdetit drejt viseve të brendshme. Më e rëndësishmja prej tyre ishte rruga që fillonte në pikën doganore të Dejës, ku bashkoheshin rrugët që vinin nga portet e Shëngjinit, të Ulqinit e të Tivarit, dhe vazhdonte nëpër luginën e Drinit për të arritur në Rrafshin e Dukagjinit, nga ku degëzohej në vendbanimet kryesore në Kosovë.²⁰ Gjithë pushtetin e Balshajve në këto treva nxitoi ta shfrytëzonte në të mirë të tregtisë së vet Republika e Raguzës, e cila më 1361 u dha tre vëllezërve Balsha qytetarinë raguzane. Të njëjtin hap e kreu një vit më vonë edhe Republika e Venedikut, e cila vëllezërit Balsha: Strazimirin, Gjergjin I dhe Balshën II i pranoi si qytetarë të vet.²¹

Fuqizimi i Balshajve, në këtë kohë u pa nga Republika e Venedikut si rrezik për synimet e saj në viset arbërore. Kështu, ajo (Republika e Venedikut) u mundua të krijonte, një kundërshtim nga ana e fisnikëve të tjerë arbër si Dukagjini, Zaharia, Dushmani, Shestani, Gjurashi, të cilët Balshajt i kishin privuar nga pushteti dhe privilegjet e dikurshme.²² Përpjekjet për t'i shtrirë kufijtë e principatës drejt jugut, i çuan Balshajt drejt përplasjes me fisnikë të tjerë arbër, Dukagjinët, Zahariajt e sidomos me Topiajt, zotër të Arbrit dhe, qysh nga viti 1364, zotër edhe të Durrësit. Në përpjekjet e Balshajve për të shtrirë zotërimet e veta drejt Durrësit, në shtator të vitit 1364 në një betejë luftarake Balshajt u mundën nga fisnikët e Durrësit dhe vetë Gjergji I Balsha, u zu rob. Me ndërhyrjen e Republikës së Raguzës, mike e dy shtëpive fisnike arbërore, Gjergji Balsha u la i lirë dhe armiqësisë iu dha fund me martesën e Karl Topisë me Katerinën, motrën e Balshajve.²³ Balshajt shënuan dhe synime për të shtrirë zotërimet e veta në grykën e Kotorrit, por hasi në kundërshtimin e

¹⁹ *Acta et diplomata*, II, dok. nr. 156, 161, f. 39-40. Në vjeshtë të vitit 1361, në Budva qeveriste fisniku Povrshko, “zot I Buduës” (dominus Budoe), fillimisht i pavarur, ndërsa më pas nën sundimin e Balshajve (*Istorijske Crne Gore*, II/2, f. 11).

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët mesjeta Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), grup autorësh, red. Kristaq Prifti, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 301.

²¹ *Po aty*, f. 301.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*.

Raguzës dhe Venedikut, të cilët e detyruan Balshën të hiqnin dorë nga një ndërmarrje e tillë.²⁴ Nga ana tjetër, në veri Balshajt arritën të mbrohen me plot sukses nga sulmet e princit boshnjak Vojsllav Vojnoviq, zotërimet e të cilit shtriheshin në verilindje të Kotorrit, pranë Budvës.²⁵ Objektivi i parë i tij ishte pushtimi i Budvës. Balshajt kërkuan të bënin aleancë ushtarake me Republikën e Raguzës, me ç’rast Raguza e mirëpriti propozimin.²⁶ Balshajt do të përballen një kohë të gjatë me tentime të feudalëve boshnjakë për të depërtuar në pjesën veriore të territoreve të principatës së Balshajve.²⁷

Në territoret e qeverisura nga Balshajt në Zetë, gjendeshin dy organizata kishtarë, katolike dhe ajo ortodokse, por popullsia ishte me shumicë katolike. Për t’iu përshtatur më mirë këtyre rrethanave, në fillim të vitit 1368, vëllezërit Strazimir, Gjergj e Balsha II, kërkuan të afrohen me kishën e Romës, duke i kërkuar papës Urbani V konvertimin e tyre në katolicizëm. Fakti është që papa i priti me entuziazëm këta proselitë të rinj, aq më tepër kur rivalët e tyre, Topiajt, nuk ishin treguar katolik besnik të Romës.²⁸ Më 29 janar të vitit 1369, në praninë e ipeshkvit të Shasit, të Ulqinit dhe të Drishtit, domenikanit Pjetër dhe fisnikut Përvoz nga Ulqini, vëllezërit Balshaj bënë betimin për kalimin e tyre në kishën katolike, duke vënë secili prej tyre vulën e përbashkët në procesverbal.²⁹ Dokumenti titullohet “*Shpallja e besimit të krishterë dhe betimi i burrave të pushtetshëm skizmatikë, zotërinjve Strazimir, Gjergj dhe Balshë, vëllezër të zhupanit dhe të zotit të provincës së Zetës në mbretërinë e Rashkës*”.³⁰ Balshajt pranuan kushtin e Papës që të hiqnin dorë nga

²⁴ *Po aty*.

²⁵ P. Bogdani, *Balshajt - Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 35.

²⁶ Republika e Raguzës e mirëpriti kërkesën e Balshajve dhe në këtë kuadër ajo pranoi të caktojë komandant qytetarin e saj Povershkon, pranë forcave ushtarake të Balshajve në qytetin e Budvës. (*Po aty*).

²⁷ Më se 60 vite Balshajt zhvilluan beteja të ndryshme për ta mbrojtur veriun nga princërit feudalë. (*Po aty*).

²⁸ Aty nga viti 1372, Papa Gregori XI e akuzonte hapur Karl Topinë për rrëshqitje në “patarinizëm”, ndërsa vite më vonë papa Bonifaci XI e fajësohte të njëjtin personazh sepse ishte lidhur me antipapën Klemment VII. (Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt – Berati dhe Vlora në shekujt XII–XV*, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2006, f. 253.)

²⁹ Gasper Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Ferizaj: Drita, 1992, f. 98.

³⁰ Ky dokument gjendet në Arkivin Sekret të Vatikanit me signaturën: *Instrumenta Miscellanea* 2526. Në pjesën e pasme ka një shënim ku thuhet: “*Professio fidei christiane et abiuratio schismatis potentu virorum dominorum Strazimir, Georgii et*

synimet mbi Kotorrin katolik si kusht paraprak për t'u kthyer në katolicizëm.³¹ Me kalimin e tyre në ritin katolik, Balshajt forcuan lidhjet me Papatin dhe me fuqitë katolike të Perëndimit. Në vitin 1370, Papa Urbani V, duke i pranuar vëllezërit Balsha në gjirin e kishës apostolike të Romës, njofton për këtë Balshën dhe peshkopët e Arbërit, Pultit, Sardës (Shurdhahut), Lezhës e të Vlorës.³²

Pas vitit 1368, veprimet e vëllezërve Balsha u përqendruan në zgjerimin e zotërimeve të tyre drejt viseve të epërme veriore arbërore (në territorin e sotëm Kosovë) dhe thellë në jug, në despotatin e Vlorës.

Forcimit të mëtejme të shtetit të Balshajve i kontribuoi përmirësimi i marrëdhënieve me feudalin e njohur arbëror Karl Topinë. Synimet e Balshajve ishin për ta marrë Vlorën. Dihet se Vlora bënte pjesë në zotërimet e marra nga Karli I Anzhu në Arbëri, në vitet 1270. Synimet e Balshajve për ta shtrirë sundimin në qytetin e Vlorës, u bënë të mundura

*Balse fratrem Zupanorum et dominorum provinciae Zente in Regno Rascie qui dicuntur esse de genere regole Conservet in archivis ecclesiae romanum. Cituar sipas Etleva Lalës, "Historia e mesjetës shqiptare sipas dokumenteve të Arkivit Sekret të Vatikanit", Revista Ekskluzive, Nr. 32-33 / XII 2002 – janar 2003, f. 96-100. Agustini Theiner, *Vetra monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia (Maximam partem nondum edita ex tabulariis Vaticanis)*, tomus primus (1198-1549), Romae: 1863, dok. nr. 362.*

³¹ Kur ipeshkvi i Shasit kishte ardhur si i dërguar i vëllezërve Balshaj, Papa kishte lajmëruar shprehimisht Gjergj Balshën se nëse dëshironte të fitonte përkrahjen e tij dhe ta pranonte në Kishën Katolike, ai dëshironte ta linte në qetësi Kotorrin, i cili prej një kohe të gjatë gjendej në armiqësi me Balshajt. "*Ut autem mereamini ad graquam reconditionis admitti, ac optiner eapostolicce sedis benivolenciam et favores, a molestiis ecclesiam et personarum ecclesiasticarum, aliorumque catholicorum abedientium dicte Romane ecciesie, presertim civitatis Catherensis, quam iamdiu a vobis seu te, Georgi, hostiliter molestari precepimus, curetis penitus abstinere, ut in hiis et aliis vestram intentionem fare purissimam ostendatis: super quibus et aliis per vos agendum in dicta vestre relaxationis negocio prefatum Episcopum duximus infomandum, ciu suoer hiis, que vobis ex partē nostra retulerit, velitis fidem indubiam adhibere*" (Cituar sipas Gj. Berishës, *Arbërorët ndërmjet kishës perëndimore ...*, f. 344-345), A. Theiner, *Monumenta Slavorum*, I, dok. nr. 362.

³² Njëpërmjet këtij fakti, kuptohet se Balshajt ishin bërë në atë kohë zotë të Vlorës. Rrethanat e zbritjes së Balshajve në Vlorë mbetën ende të errëta. Por është e sigurtë që në themel të kësaj ngjarjeje qëndronte aleanca e Balshajve me zotin e fuqishëm të Beratit, despotin Andrea II Muzaka, i cili në atë kohë e zotëronte, ose të paktën e kishte nën kontrollin e tij qytetin e Vlorës bashkë me kështjellën e Kaninës. Aleanca e Balshajve me Muzakajt e Beratit u vulos me martesën e Komnenë Muzakës, vajza e despotit Andrea, me më të voglin e sundimtarëve të Gentës, Balshën II (*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 302.)

në bashkëpunimin ushtarak me Andrea II Muzaka, i cili kishte në zotërim qytetin e Beratit si dhe atë të Vlorës, ose të paktën e kishte nën kontroll, pasi zotëronte kështjellën e Kaninës.³³ Bashkëpunimi i Balshajve me Muzakajt u arrit dhe me martesën e Komnenë Muzakës, vajzës së despot Andreas, me Balshën II.³⁴ Andrea II Muzaka në vitin 1369, i ndodhur përballë pushtimit të befasishëm të Vlorës e Kaninës nga ana e Balshajve të Shkodrës, nuk i mbetej gjë tjetër veçse të njihte faktin e kryer dhe të tentonte të kthente në aleat “*uzurpatorin*”, Balshajt për t’i angazhuar ata në lindje, kundër mbretit Vukashin.³⁵ Shkaku i konfliktit të Muzakajve me Vukashinin ishin zotërimi i viseve të Maqedonisë Jugperëndimore me Kosturin. Pasi, aty nga viti 1369, Simeon Uroshi kishte vdekur, Andrea II Muzaka dhe Vukashini pretenduan që të përvetësonin trashëgiminë e tij në këto anë. Por, ndërsa mbreti Vukashin i pretendonte këto vise si bashkëregjent i carit Stefan Uroshi, Muzakajt i pretendonin ato në emër të së drejtës (të drejtën e territorit kombëtar) (*juspatriate*) pasi mali i Peristerit ishte kufiri që ndante Arbërinë me Bullgarinë.³⁶ Dokumentet e shek. XIV e quajnë Kosturin pjesë të Arbërisë (Castoria in partibus Albaniae).³⁷ Beteja e Peristerit e vitit 1369 u mbyll me fitoren e Andrea II Muzakës, ushtria e Vukashinit u shpartallua keq dhe vetë mbreti serbo-bullgar u zu rob nga një luftëtar i Muzakës, i quajtur *Dusland*.³⁸ Fitorja e Andrea Muzakës kundër Vukashinit rihapte mundësinë e shtrirjes së sundimit bizantin në këtë pjesë të Arbërisë së dikurshme bizantine nga ku ishte larguar gati tridhjetë vjet më parë.³⁹ Ndaj në këmbim të kësaj

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ Ardhja e Balshajve në Vlorë përkoi me një moment kritik të marrëdhënieve të despotit Andrea II Muzaka me Mbretin Vukashin të Maqedonisë. Vukashini që në vitin 1365 u shpall mbret trashëgimtar i fronit serb, arriti të krijojë një zotërim të gjerë në rajonet e Maqedonisë Perëndimore. Zgjerimi në drejtim të perëndimit përbënte, në këtë kohë, drejtimin kryesor të politikës. Në fund të viteve 60-të, sundimi i tij shtrihej në Prizren, në Shkup e deri në zonën e Korçës, ku për llogari të tij sundonte Qezari Novak. Po ky projektim drejt perëndimit e përplaste pashmangësish Mbretin Vukashin me despotin e Beratit, Andrea II Muzakën. Konflikti me Vukashinin e frenoi depërtimin e Muzakajve drejt Vlorës në veri të Shkumbinit. (P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt* ..., f. 259.)

³⁶ *Po aty*, f. 262.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ Në gjirin e vogël të Gramës, midis Dhërmiut e Kepit të Gjuhëzës, në vitin 1369 ishte strehuar një flotë ku ishte edhe vetë Perandori Joani V Paleolog i nisur drejt

fitoreje, perandori i Bizantit i dhuroi Muzakës emblemën perandorake, shqiponjën dykrenore me yll në mes.⁴⁰ Me këtë rast perandori bizantin i akordoi Andrea Muzakës titullin e despotit me privilegj të veçantë, shënuar me vulë të artë.⁴¹

Marrja e Vlorës nga ana e Balshajve ka koiciduar me kohën e përplasjes së Andrea Muzakës me mbretin Vukashin, në lindje. Ekspedita e Balshajve për në Vlorë mund të jetë kryer me anë të detit, por nuk përjashtohet mundësia që ato të kenë hyrë në qytet nga ana e tokës, duke shfrytëzuar kalimin nëpër territoret e Topiajve. Dihet se me lirim të Gjergj Balshës nga burgu i Karl Topisë⁴² dhe martesën e Katerinës, motrës së Balshajve me Karl Topinë, në marrëdhëniet midis dy familjeve princërore arbërore fillon një periudhë paqeje relative, gjë që e mundësonte të drejtën e kalimit (*juspasagii*) në ushtrinë e Balshës nëpër zotërimet e kumatit.⁴³

Kosova pjesë e zotërimeve të Balshajve

Kryezotërinjtë Balsha (vëllezërit Strazimir II Balsha, Gjergji I Balsha II),⁴⁴ arritën të shfrytëzonin situatën e krijuar pas disfatës dhe dobësimit të feudalëve serbë në Betejën e Maricës, 1371. Balshajt shtrinë zotërimet e tyre në jug në Vlorë, Berat, Përmet, Ohër, Korçë. Më vonë, Balsha II në bashkëpunim me Andrea Muzakën, i mori Mark Krajleviçit, qytetin e Kosturit më 1372, që ndodhej nën sundimin e feudalit sllav, Marko.⁴⁵ Balsha II mori pjesë në betejën për Kosturin në cilësinë e dhëndrit të despotit Muzaka.⁴⁶ Sundimi i feudalëve sllavë në Kosovë dhe

Venedikut. Në faqe të një shkëmbi, mbushur me shkrime të lundërtarëve nga të gjitha kohërat, gjendet edhe një mbishkrim elegant, që thotë: “*në vitin 1369 erdhi këtu Perandori i Bizantinëve Joan Paleologu*”. (*Po aty*).

⁴⁰ *Po aty*.

⁴¹ *Acta et Diplomata*, I, dok. nr. 808.

⁴² Në vitin 1364, në luginën e Matit, ndodhi konflikti i armatosur mes Gjergjit I Balsha dhe Karl Topisë. Në nëntor të atij viti Gjergji I Balsha ra rob në duart e Karl Topisë. (Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane ...*, f. 88).

⁴³ P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt ...*, f. 250.

⁴⁴ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët ...*, f. 25.

⁴⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 302.

⁴⁶ Ka mendime të ndryshme se si është marrë qyteti i Kosturit nga Balsha II. Mendohet se Balsha II e mori qytetin me pëlqimin e Helenës, atëherë kur bashkëshorti i saj, Markoja nuk ndodhej aty. Mirëpo, bazuar edhe në burime historike ka mendime të

në viset jugore të Shqipërisë u mënjana duke u vendosur autoritetet qeverisëse të Balshajve. Në këtë kohë udhëheqës i Dinastisë së Balshajve, pas vdekjes së Strazimir II Balsha 1372, u vu Gjergji I Balsha. Ky filloi ekspeditën ushtarake për të bashkuar nën autoritetin e tij, fillimisht territorin e Kosovës. Në krye të ushtrisë u nis vetë Gjergji I Balsha. Por, veprimet ushtarake këtu u përdorën fare pak, dhe vetëm ndaj një rrethi të caktuar feudalësh sllavë. Përkundrazi, popullsia kudo në territorin e Kosovës i priti Balshajt me entuziazëm. Kjo ngjarje ndezi këngë në shpirtin e popullit, në të cilin Balshajt u fiksuan me epitelin kuptimplotë "çlirimtarë".⁴⁷ Kjo shpjegohet me faktin e shtypjes së rëndë që kishte ushtruar aty sundimtari Vukashin. Rezistenca ishte fare e dobët, nga një numër i vogël feudalësh, sigurisht sllavë. Fillimisht, Gjergji I Balsha i zgjeroi territoret duke zotëruar qytetin e Prizrenit (1371)⁴⁸ dhe atë Pejës⁴⁹. Në shenjë falënderimi dhe përkrahjeje për qeveritarin e tyre Gjergji I Balsha, tregtarët prizrenas, me rastin e hyrjes së tij triumfale në atë qytet, i dhuruan katër parzmorë, secila me vlerë prej pesë librash argjendi, një shumë e mirë për atë kohë.⁵⁰ Më pas, Gjergji I u nda nga motra e Vukashinit dhe u martua me Teodorën, të venë e fisnikut malazez Zharko.⁵¹ Gjergji I Balsha arriti ta shrinte autoritetin e tij qeverisës në tërë territorin e Kosovës. Territori i Kosovës për Balshajt në këtë kohë ishte i një rëndësie të veçantë në përputhje me nevojat objektive të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik të shtetit të tyre. Ndërmjet Kosovës dhe viseve të tjera arbërore që gjendeshin në kuadrin e shtetit të Balshajve në atë kohë ekzistonin lidhje të rëndësishme ekonomiko-tregtare. Njëpërmjet eksportimit të grurit e plumbit nga Kosova nëpër rrugën e Zetës, në Shkodër, Lezhë e Tivar, sigurohej furnizimi i Kosovës

studiuesve që Andrea II Muzaka, ia mori Kosturin me luftë sundimtarit Marko. (P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt ...*, f. 273)

⁴⁷ Historiani kroat me prejardhje arbëreshe, Giuseppe Gelcich, për momentet e para të hyrjes së Balshajve në Kosovë, shkruan se kjo ngjarje qe e jashtëzakonshme. "Kjo shkruan, G. Gelcich "...del si përfundim nga fakti se në atë rrethanë, krerët e familjeve të ndryshme raguzane me banim në Prizren, u thirrën për të dhënë kontributin e tyre me ndonjë dhuratë, me anën e së cilës kolonia e tregtarëve prizrenas, do të shprehin entuziazmin e vet për ngadhënjimin e kauzës së Balshës..." (G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 94.)

⁴⁸ P. Shufflay, *Serbë dhe shqiptarët ...*, f. 36.

⁴⁹ G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 92.

⁵⁰ *Po aty.*

⁵¹ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane ...*, f. 65.

me kripën e Durrësit e Vlorës, me stofra e prodhime nga qytetet dalmatine e të bregut perëndimor të Adriatikut.⁵² Pikërisht në saje të pritjes së favorshme që gjeti Gjergji I Balsha në krahinën e Kosovës, shteti i Balshajve u konsolidua për një kohë të shkurtër.

Këto territore nga vitet 1371-1385 qëndruan në kuadrin e shtetit arbëror të Balshajve. Treva e Kosovës së sotme që mbeti nën administrimin e Balshajve gjatë viteve 70-të dhe 80-të të shek. XIV përfshinte veprimtaritë që nga tregjet dhe doganat e Prizrenit, deri edhe sferën tregtare të doganës në Kriva Rekë (Novo Bërdë), ku u vendosën organet financiare të familjes së Balshajve.⁵³

Duke përfituar nga kriza e sundimtarëve sllavë në trevat veriore të Arbërisë (në Kosovë), Balshajt u bënë zotër të këtyre territoreve, kufijtë e të cilave shtriheshin në veri në Budva, në jug në Himarë, prej Adriatikut në perëndim, deri në Kriva Rekë në Kosovë dhe në Kostur në lindje të Shqipërisë⁵⁴. Si zotër të pavarur, ata emetojnë në vitet 1372-1378 monedhat e tyre në të cilat vënë jo sovranë serbë, por veten e tyre me shënimin “... *I devotshmi ndaj perëndisë të Krishtit zoti Gjergj*” apo “*I caktuar nga perëndia zotëria i madh Gjergj*”⁵⁵. Ngritja e Balshajve si zotër të pavarur duket qartë në titujt që përdornin në privilegjet lëshuar raguzanëve. Në akt dhuratën e vitit 1386, Gjergji II Balsha, thoshte në intitullaturë (titullim)⁵⁶: “*Unë..., sundimtar sovran i gjithë Zetës dhe tokave bregdetare*”⁵⁷.

Në këtë kohë nga burimet historike do të shohim se marrëdhëniet midis shtetit të Balshajve dhe Raguzës ishin në nivel të lartë në raportet e shumta politike e ekonomike. Sipas dokumentit të 17 janarit 1368, të tre

⁵² Pranvera Bogdani, “Prirjet drejt bashkimit shtetëror të trojeve shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV”, në *Konferenca kombëtare për formimin e popullit shqiptar të gjuhës dhe të kulturës së tij*, (Tiranë, 2-5 korrik 1982), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1988, f. 123.

⁵³ Balš (II) Ragusinis dat potestatem in suis terris libere mercaturam faciendi; “portorium solvant, sicut etiam prius, binos denarios pro sacco Dagniautem et super Kriva Reka solvant, sicut solvebant vivente fratre meo domino Georgio”, *Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 364, f. 86.

⁵⁴ P. Bogdani, *Balshajt - Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 45.

⁵⁵ Luan Malltezi, *Beteja e Fushë-Kosovës dhe shqiptarët, 1389*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1999, f. 25.

⁵⁶ Intulacioni përmban emrin dhe titullin e autorit që jep dëshminë (poveljen). Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV – XVI*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1995, f. 25.

⁵⁷ L. Malltezi, *Beteja e Fushë-Kosovës ...*, f. 24.

vëllezërit Balsha (Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II) i përjashtojnë raguzanët nga taksa e re doganore e Danjës “...u falëm taksën doganore në Danjë duke u mundësuar atyre që të kalonin lirisht nëpër tokën tonë, pa qenë të detyruar që t’i paguanin askujt këtë taksë doganore...”⁵⁸. Që territori i Kosovës së sotme ishte në kuadër të shtetit të Balshajve dëshmon dokumenti apo marrëveshja politike-tregtare ndërmjet Gjergjit II Balsha dhe Raguzës, lëshuar më 20 nëntor 1379. Sipas këtij dokumenti, raguzanët ishin të obliguar që të paguanin taksë doganore nëpër territorin e shtetit të Balshajve ku ceken vendet doganore “...Dhe në Danjë dhe në Kriva Rekë (afër Novo Bërdës) të paguanin aq sa kanë paguar kur ka qenë gjallë vëllai im, zoti Gjergji...”⁵⁹ Me këtë dokument shteti i Balshajve përmes sundimtarit të vet Balsha II i konfirmon qytetit të Raguzës edhe privilegjet e vjetra që kishin të bënin me tregti, ku thuhet “...Të kalojnë tregtarët raguzianë nëpër tokën time (shtetin e tyre) dhe të blejnë çfarëdo malli dhe drithë dhe ta dërgojnë kudo që dëshirojnë... Dhe të paguajnë taksën doganore që e kanë paguar më parë, domethënë nga 2 dinarë për thes...”⁶⁰ Nga këto marrëveshje (akte normative) shteti i Balshajve garantonte sigurinë dhe mbrojtjen e çdo veprimtari tregtar në territorin e tyre. Kështu, sundimtarët Balsha shpallnin: “...Dhe për këtë japim besën tonë, unë Strazimiri, Gjergji dhe Balsha se çdo njeriu të qytetit tuaj që do të gjendet me mall, në bazë të besës sonë i është falur kjo taksë doganore dhe nuk do t’i merret për sa kohë do të jemi gjallë dhe për ta bërë të besueshme këtë vumë vulën tonë”.⁶¹ Qeverisja e zotërimeve të Balshajve realizohej nga tre vëllezërit: Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II. Aktet zyrtare firmoseshin njëherësh prej tyre dhe vuloseshin me vulën e përbashkët. Po ashtu në nënshkrimin e këtyre akteve si rregull ishin të pranishëm të tre vëllezërit Balsha. Në saje të shtrirjes së gjerë territoriale, rezidenca e principatës ishte e lëvizshme, si në Ulqin, në Tivar, në Shkodër e në Vlorë. Për muajt e verës ata shpërnguleshin në rezidencën e tyre verore, që ndodhej në malësinë e Tivarit. Funksionimi i sistemit politik të pavarur të principatës së Balshajve, bazohej në traditën patriarkale feudale me respektim të kriterit

⁵⁸ *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëllimi II (shek. VIII-XV), përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashri, Petraq Pepo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962, dok. nr. 110, f. 184-185.

⁵⁹ *Po aty*, dok. nr. 112, f. 186.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, dok. nr. 110, f. 185.

të moshës në marrjen e pushtetit.⁶² Balshajt kishin administratë të përfaqësuar nga personat me autoritet me tituj si *provestiar, vojvodë, logotet*. Ata kishin zyrat administrative, me shkruer, noter, sekretar, kishin vulën dhe shenjat e tyre dalluese që shprehnin pushtetin dhe sovranitetin e tyre.⁶³

Princi Balsha II dhe përpjekja për krijimin e një shteti unitar arbëror

Në vitin 1378 në krye të principatës së Balshajve erdhi Balsha II. Tashmë Balsha II ishte princi më i fuqishëm në Arbëri. Mbishkrimi i vitit 1373 mbi të ashtuquajturin “Epitaf i Glavinicës”, që mban datën 22 mars 1373, i cilëson Gjergjin I dhe Balshën II si zotër të “Serbisë, Romanisë dhe të gjithë Arbrit”.⁶⁴ Kështu, në vitin 1373, vëllezërit Balsha, që burimet serbe i përcaktojnë si “sundimtarë arbërorë (*arbanski gospodin*), ata e cilësojnë veten, veç të tjerash, si “zotër të Serbisë”. Por, do të ishte fare e gabuar të merrej ky pohim i tyre fjalë për fjalë. Realisht, në vitin 1373, Balshajt ishin zotër vetëm të një pjese të shtetit serb të kohëve të Nemanjës. Pra, ishin zotër të Kosovës, të cilën ata e kishin marrë një vit më parë nga mbreti Vukashin.⁶⁵

Por gjithsesi, projekti i Balshajve ishte ta shtrinte pushtetin e vet, qoftë me forcën e armëve e qoftë nëpërmjet aleancave familjare, në thellësi deri në Despotatin e Epirit.⁶⁶ Pjesëmarrja e Balshës II në betejën për marrjen e Kosturit, duhet parë në kontekstin e ambicieve të Balshajve për të ngritur një shtet të madh të tyren. Heqja dorë nga ekspansioni drejt veriut (Kotorrit) dhe orientimi i tyre politik në trevat me popullsi arbërore, sa në veri (Kosovë), aq edhe në jug (Vlorë - Berat dhe Epir),

⁶² Strazimiri, si vëllai më i madh, kishte gjithmonë privilegjin e moshës në marrëdhënie me vëllezërit. Pas vdekjes së Strazimitit më 1373, i biri i tij, Gjergji II si më i riu, në aktet zyrtare përmendet pas xhaxhallarëve të tij, Gjergji I dhe Balsha II. Pas vdekjes së Gjergjit I Balsha, më 1378, Balsha II e largoi nga pushteti nipin e tij, Gjergji II Balsha dhe mori qeverisjen e gjithë zotërimeve në shtetin e Balshajve. (*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 303).

⁶³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 303.

⁶⁴ P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt ...*, f. 273.

⁶⁵ *Po aty*, f. 274.

⁶⁶ Në këtë vështrim duhet kuptuar edhe martesë e Evdoqia Balshës me despotin e Epirit, Ezau Buondelmonti Açaiuoli, më 6 gusht 1403. Evdoqia ishte motra e Gjergjit II Strazimir Balshës. (*Po aty*, f. 276, referenca 4).

flasin për atë, që Balshajt u orientuan drejt ngritjes së një shteti me karakter nacional.⁶⁷

Kështu në vitet 70-të të shek. XIV, vëllezërit Balsha së bashku me princër të tjerë shqiptarë të cilët ishin nën autoritetin politik të Balshajve, shtrinë zotërimin e pavarur qeverisës deri në rrjedhën e lumit Mat, dhe në Kosovë, nga Prizreni e Peja deri në Kriva Rekë (pranë Novobërdës). Në këtë mënyrë, vëllezërit Balsha në këtë kohë kishin bashkuar viset shqiptare nën sundimin e tyre, viset e Lezhës, Matit, Kosovës, Dibërës, Ohrit e Kosturit.⁶⁸ Kurse qytetet jugore shqiptare qeveriseshin nga princër të tjerë shqiptarë: Zenebishët qytetin e Gjirokastrës, ndërsa princërit Shpataj kishin Çamërinë e Artën. Kësisoj trevat shqiptare në këtë kohë qeveriseshin nga princërit e pavarur arbër.

Shteti i Balshajve do të arrijë një zhvillim ekonomik dhe prosperitet politik më të theksuar në kohën e Balshës II (1379-1385), figura më e shquar e Balshajve. Ky sundimtar, për sa i përket politikës së brendshme, ndërmori masat e duhura për përqendrimin e të gjithë pushtetit në duart e veta. Në këtë kuadër, ai arrestoi nipin e tij, Gjergjin II Balsha, në kështjellën e Durrësit, për shkak të “*mosdëgjueshmërisë*” dhe nga frika se ai mund të qeveriste nga Zeta.⁶⁹ Po ashtu Balsha II mori masa edhe në fushën e doganave. Kështu, në nëntor të vitit 1379, Balsha II konfirmoi vendimin e mëparshëm të Gjergji I për pagesën e taksës doganore, 2 dinarë për thes, nga tregtarët raguzanë në Dejë dhe në Kriva Rekë.⁷⁰ Balsha II në vitin 1379 paraqitet si sundimtar i vetëm. Ai me anën e martesës, me Kominën zotëroi si prikë Vlorën dhe Beratin.

Në vitin 1382, Balsha II ra në konflikt me mbretin boshnjak Tvërtko, i cili në pranverë të po atij viti, ndërtoi një kështjellë në lumin Sutorin, në hyrje të Grykës së Kotorrit për marrjen e qytetit të Kotorrit dhe për të depërtuar në territoret e Balshajve.⁷¹ Prezenca e Tvërtkos në Grykën e Kotorrit, pa dyshim se ishte lajm jo i mirë për Balshën II. Prandaj, për të mënjatur rrezikun, ai nxitoi dhe rrethoi qytetin e

⁶⁷ *Po aty*, f. 276.

⁶⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 303.

⁶⁹ Михаило Динић, *О Николи Алтомановићу*, Посебназдаца–Друштвени и историскириси СКА кц, ХС/40, Београд: 1932, f. 35-37; *Историја Црне Горе ...*, II / 2, f. 34-35.

⁷⁰ *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë ...*, dok. nr. 112, f. 186.

⁷¹ *Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 327, f. 54.

Kotorrit.⁷² Në vjeshtë të vitit 1382, e në fillim të 1383-it, Balsha II nuk ia arriti qëllimit të merrte qytetin e Kotorrit, pasi raguzanët ishin kundër tij. Në mesin e vitit 1384, Kotorri njohu sundimin e feudalit boshnjak Tvertkos, dhe me këtë, pozita e Balshajve në veri u bë edhe më e vështirë. Pozita e Balshajve në viset verilindore po keqësoj edhe më shumë, pasi feudali serb Llazar Grbljanoviç kishte depërtuar në Kosovë dhe kishte marrë pikën doganore të Kriva Rekës.⁷³

Me një sulm të befasishëm në vitin 1384, Balsha II pushtoi Durrësin.⁷⁴ Karl Topia, u detyrua të tërhiqej në kështjellën e Krujës. Balsha II, më tej, i shtoi emrit të tij edhe titullin e “dukës së Durrësit” (dux Dyrrachi).⁷⁵ Në këtë mënyrë, zotërimet veriore të Balshajve dhe ato jugore u lidhën midis tyre me një vazhdimësi territoriale, pra me viset e Arbërisë së Mesme, duke krijuar formacionin më të madh mesjetar arbëror që ishte deri në atë kohë.⁷⁶ Pushteti suprem i Balshajve, në fakt duhet të jetë shtrirë edhe në një pjesë të viseve të sotme të Maqedonisë Perëndimore. Është fjala për Ohrin me rrethinë, që siç dihet, pas vitit 1380, ishte nën sundimin e princit të Arbërit, Karl Topisë. Ky i fundit, logjikisht, u ndodh nën pushtetin suprem të Balshës II.⁷⁷

Në vitin 1385, zotërimet e Balshajve u prekën seriozisht nga sulmet osmane. Këtë situatë rreziku e kishte të qartë Balsha II. Ai njofton Venedikun, se si osmanët, nga dita në ditë, sulmonin dhe shkretëtonin atdheun e tij, në atë masë sa në qoftë se nuk do t’i jepej ndihma sa më shpejt, kjo situatë jo vetëm që do të ishte në dëm të nënshtetaseve të Balshës II, por do të godiste rëndë edhe interesat e tregtarëve venedikas, të cilët kishin liri tregtare në shtetin e Balshajve⁷⁸. Mbi këto shkaqe, Balsha II kërkonte ndihmë nga Venediku (katër galera të armatosura) për t’iu kundërvënë inkursioneve osmane.⁷⁹

Edhe pse të dhënat burimore mbi kohën dhe mënyrën e depërtimeve osmane në trevat juglindore të Balshajve mungojnë,

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*, dok. nr. 388, f. 54.

⁷⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 290.

⁷⁵ Milan Šufflay, *Historia e shqiptarëve të veriut (Studim sociologjik)*, Prishtinë: 2009, f. 29.

⁷⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 304.

⁷⁷ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane ...*, f. 78.

⁷⁸ Q. Dalipi, *Inkursionet osmane në trevat Shqiptare deri më 1402 ...*, f. 71.

⁷⁹ *Po aty*.

konsiderohet se qyteti i Kosturit ra në duart e osmanëve në vitin 1385, përpara betejës së Savrës⁸⁰. Me këtë rast Kosturi u bë bazë e fortë ushtarake për depërtime të mëtejme të osmanëve drejt trevave jugore të Balshajve. Ushtria osmane prej 5 000 trupash⁸¹ erdhi nëpër territoret e Muzakajve dhe iu bashkua Karl Topisë⁸² dhe që, bashkë me forcat e tij, depërtuan në trevat e Balshës II, i shkretuan ato dhe arritën deri pranë Beratit.⁸³ Kur Balsha II e mori vesh këtë nuk priti që të mbledhë numrin e

⁸⁰ *Po aty*, f. 72.

⁸¹ Ka disa mendime se kush e udhëhoqi ushtrinë osmane. Disa studiues mendojnë se ushtria osmane u udhëhoq nga bejlerbeu i Rumelisë, Timurtash Pasha. “*Kur Balsha II ishte i zënë në konflikt me mbretin e Bosnjës, Tvërtkon (1376-1391), për çështjen e zotërimit të Kotorrit, një ushtri e fuqishme osmane, e komanduar nga Timurtash Pasha, në shtator të vitit 1385 u fut me shpejtësi në thellësi të tokave arbërore. Balsha II së bashku me një grup fisnikësh të udhëhequr prej tij, mobilizuan me shpejtësi një pjesë të ushtrisë dhe i dolën përpara osmanëve në fushën e Savrës (pranë Lushnjës)*” (*Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 375). Gjithashtu nuk mund të përjashtohet edhe mundësia që Timurtash Pasha, që komandonte gjithë ushtrinë (në Rumeli), të ketë dërguar në Savër vetëm një pjesë të forcave të veta, duke i vënë nën komandën e Evernozit. (Selami Pulaha, “Luftërat shqiptaro-turke në veprat e kronistëve dhe historianëve osmanë të shekujve XV - XVII”, në *Studime për epokën e Skënderbeut*, III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë:1989, f. 404). Studiues të tjerë konsiderojnë se forcat osmane komandoreshin nga Hajredin Pasha, “*Karl Topia kishte arritur më në fund t’i bindte osmanët) që ti shpallnin luftë Balshës II: Hajredin Pasha, në krye të një ushtrie të armatosur mirë kishte hyrë deri në Berat, duke i vënë zjarrin mbarë qytetit*”. (G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 147). “*Balsha II mundi të ndërtojë e t’u kundërvihet ushtrive osmane të Hajredin Pashës në betejën e përgjakshme të Savrës (Lushnjë), me 18 shtator 1385*”. (Pëllumb Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në betejën e Kosovës”, në *Beteja e Kosovës 1389 (Përmbledhje studimesh)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2005, f. 105). Ka mendime se të dyja kanë marrë pjesë në betejën e Savrës. Sipas kronistit të vjetër osman, Oruç ben Adil, kronistit shqiptar Marin Barleti dhe historianit italian Orbini, veprimet ushtarake i drejtoi veziri Hajredin Pasha së bashku me Evernos Beun, komandant i forcave kufitare të Ballkanit, natyrisht nën komandën e përgjithshme të Timurtashit. (Kristo Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra (1405 – 1468)*, Tiranë: Toena, 2002, f. 38).

⁸² P. Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt ...*, f. 312.

⁸³ Për këtë depërtim të parë të osmanëve në trevat arbërore, historianët zakonisht ia ngarkojnë fajin Karl Topisë. Thonë se për të rimarrë Durrësin, Karli iu drejtua për ndihmë osmanëve, të cilët u dyndën në Arbëri më 1385. Ky version e ka fillin te M. Barleti. Karl Topia kishte arritur më në fund t’i bindte osmanët që t’i shpallnin luftë Balshës II. (G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 147). Fuqizimi i Balshajve, sidomos pas marrjes së Durrësit, shkaktoi reagimin armiqësor të feudalëve të tjerë. Ndër ta ishte edhe Karl Topia, që thirri në ndihmë forcat osmane (*Fjalor*

nevojshëm të ushtarëve, ndonëse bashkëpunëtorët e tij feudalë e këshilluan që t'i ikte konfrontimit me ushtrinë osmane deri sa të mblidhte një ushtri më të madhe. Ai marshoi me 1000 kalorës nga Durrësi duke u lëshuar kundër osmanëve. Në betejën që u zhvillua pranë lumit Vjosë, në Savër të Lushnjës pas një lufte heroike, nuk arriti që t'i rezistojë sulmit të armikut që numëronte 5000 ushtarë.⁸⁴

Konfrontimi ndërmjet ushtrive kundërshtare që i ashpër. Në fushën e betejës që u zhvillua më 18 shtator 1385, mbetën të vrarë shumë ushtarë nga të dy palët, në mesin e të cilëve ishte edhe Balsha II. Disfata e forcave të arbërve në Savër, ku gjeti vdekjen edhe Balsha II, që më mirë se kushdo sundimtar tjetër arbër ishte bërë shprehës i aspiratave për krijimin e një shteti të përqendruar arbëror, shënoi një fazë të re të ndërhyrjes osmane në trevat arbërore. Duke filluar nga ajo kohë, nis pushtimi i vërtetë i qëndrueshëm i tyre.⁸⁵ Disfata në Savër tronditi rëndë themelet e shtetit të Balshajve. Megjithatë, me disfatën e Savrës, Arbëria nuk u pushtua. Ushtria osmane u largua. Ajo hyri vetëm nën vasalitetin e sulltanit. Sidoqoftë me vendosjen e vasalitetit osman, procesi i bashkimit të vendit në një shtet të vetëm arbëror jo vetëm u pengua, por bëri disa hapa prapa, mbasi në një kohë të shkurtër u kalua në proces copëzimi.⁸⁶

Pas kësaj ngjarjeje shteti i arbit mori goditje të rëndë. Revolta separatiste e feudalëve arbër që shfaqur fuqishëm. Kështu Principata e Balshajve u nda në tri pjesë: në Arbërinë e Jugut ku vazhdoi të sundonte e veja e Balshës II, Komnenë Muzaka, e cila nuk ishte në lidhje varësie

Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f. 162). Duhet thënë se asnjë nga kronistët dhe historianët e vjetër osmanë nuk flet për ftesë të tillë. Sipas tyre osmanët kryen një fushatë ushtarake në Arbëri qysh në vitin 1384, para se Durrësi të binte në dorë të Balshës. Këtë fushatë e kryesoi bejlerbeu i Rumelisë, Timurtashi, dhe u drejtua kundër *Karli-ilis (Vendi i Karlit - kështu e quajnë kronistët osmanë Principatën e Durrësit, sipas emrit të sundimtarit të saj, Karl Thopia)*. Kronisti osman me origjinë persiane Idris Bitlis, vepra e të cilit përmban njoftime më të hershme dhe më të pasura mbi Shqipërinë, thotë se Timurtashi e pushtoi “Vendin e Karlit”, e pastroi nga kundërshtarët e sulltanit, e detyroi të paguante xhizjen dhe e bashkoi këtë vilajet me Manastirin. Kronisti tjetër turk Ashi Pasha-zade, duke folur për ekspeditën e Timurtash Pashës kundër Karli-ilis, shënon vitin 787 të hexhirës, që i takon kryesisht vitit 1385. (Cituar sipas K. Frashëri, Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra ...*, f. 37).

⁸⁴ G. Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve ...*, f. 147.

⁸⁵ P. Xhufi, “Shqiptarët e Jugut në betejën e Fushë-Kosovës”, në *Beteja e Kosovës 1389 ...*, f. 106.

⁸⁶ K. Frashëri, Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra ...*, f. 39.

me Gjergjin II Balsha; në Arbërinë e Mesme përkatësisht qytetin e Durrësit e shtiu në dorë përsëri princi Karl Topia, por edhe ky, tashmë nën presionin e vazhdueshëm osman, e kishte humbur pushtetin e dikurshëm; gjendja më e qëndrueshme ndodhi në zotërimet e Arbërisë së Veriut, ku në krye të së cilave u vu nipi i Balshës II, respektivisht djali i Strazimir Balshës, Gjergji II Strazimir Balsha 1385-1403.⁸⁷ Ai mundi të shpëtonte pjesërisht zotërimet e Gentës. Ato të Kosovës, në pjesën më të madhe, ranë në dorë të princërve sllavë, vasal të sulltanit.⁸⁸ Nga pushteti i tij, të parët u shkëputën vëllezërit Sakati – Zaharia, ndërsa Dukagjinët u pavarësuan në Zadrimë dhe në Lezhë. Midis Rrëshenit dhe Lezhës në mënyrë të pavarur qeverisnin Jonimët. Në Zetën e Epërme u pavarësuan Cërnojeviqët,⁸⁹ që mbështeteshin nga fqinjët e tyre, zotërinjtë boshnjakë dhe mbreti Tvërtko. Zotërimi i Cërnojeviqëve përfshinte masivin malor mbi Grykën e Kotorrit dhe Budvës, një fshat në Tejbunë (Obilik) dhe dy fshatra në rrethinën e Shkodrës (Samarisht dhe Grisha), si dhe disa fshatra në Zetën e Epërme, në kufi me Bosnjën.⁹⁰

Në një situatë të tillë të krijuar nga sulmet osmane, territori i Balshajve humbi terren duke u përkufizuar në krahinat e Shkodrës, të Drishtit, të Ulqinit dhe Tivarit.⁹¹ Sundimtar në këto krahina u bë nipi i Balsha II, Gjergji II Strazimir Balsha (1385-1403). Për të mos humbur krejtësisht zotërimet e mbetura, Balshajt pranuan që të hynin nën vasalitetin osman.⁹² Vasalitetin me osmanët, Gjergji II Strazimir Balsha u përpoq ta shfrytëzonte për ngritjen ekonomike të vendit të tij. Ai përmes një diplome, të përpiluar më 27 janar të vitit 1386 në Shkodër, u vërtetoi raguzanëve privilegjet e mëparshme tregtare dhe i siguroi tregtarëve liri

⁸⁷ *Acta et diplomata*, II, dok. nr. 391, f. 55.

⁸⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 304.

⁸⁹ Familja bujare e Cërnojeviqëve ishte me prejardhje shqiptare (arbërore - B.M.), më pas e sllavizuar. (*Fjalor*, 361).

⁹⁰ Pranvera Bogdani, “Prijet drejt bashkimit shtetëror të trojeve shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe në fillim të shekullit XV”, në *Studime për epokën e Skënderbeut*, III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 11; Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane ...*, f. 78.

⁹¹ Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas (1392-1478)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1988, f. 53.

⁹² Rrethanat e hyrjes së Gjergjit II Balsha nën vasalitetin osman janë të pasigurta. Megjithatë, mund të supozohet se një akt i tillë ishte bërë menjëherë pas vrasjes së xhaxhait të tij, Balshës II. (*Po aty*).

të lëvizjes nëpër tokën e tij, duke u garantuar kompensim për dëmet që mund të kishin eventualisht. Tregtarët raguzanë lirohen nga pagesa e taksës së doganës në Dejë. Mirëpo, për drithin që do të blinin në vendin e tij, ata duhej të paguanin doganë dy dinarë për çdo *sacco* (peshë prej 12-14 kg.).⁹³ Marrëdhëniet me Raguzën vazhduan të jenë të mira, kështu që, në fillim të shtatorit të vitit 1388, Gjergji II Strazimir Balsha fitoi të drejtën e “qytetarisë raguzane”.⁹⁴ Në këtë kohë, Gjergji II Strazimir Balsha në përpjekje kundër osmanëve planifikonin që të krijonin një aleancë me Lazar Hrebëlanoviçin dhe mbretin e Bosnjës, Tvërtkon, me të cilin kishte pasur deri tani marrëdhënie armiqësore. Gjergji II Strazimir Balsha u martua me Helenën, vajzën e princit Lazar të Rashës. Kështu, ai u bë kunat edhe me feudalin tjetër serb Vuk Brankoviçin.⁹⁵ Më 1388, ai u rreshtua përkrah aleatëve serbë e boshnjakë në betejën e Bileqës në Bosnjë kundër sulmeve pushtuese osmane.⁹⁶ Sipas kronikave osmane, Gjergji II Strazimir Balsha luajti rol të rëndësishëm në fitoren kundër ushtrive osmane të komanduara nga Lala Shahini. Këtë disfatë burimet osmane e paraqesin si një vepër kurthi të organizuar nga sundimtari i Shkodrës, Gjergj II Strazimir Balsha⁹⁷. Forcat osmane, nën komandën e Lala Shahinit, që në këtë kohë depërtuan në Bosnjë, u thyen rëndë nga forcat aleate të Tvërtkos, Gjergjit II Strazimir Balshës dhe Lazarit⁹⁸. Në këtë disfatë të osmanëve, rolin udhëheqës e kishte pasur Gjergji II Strazimir Balsha, sepse siç pohon kronisti osman Bitilsi, “*ai ishte bërë shkak për vrasjen e 10 deri 15 mijë luftëtarëve*”⁹⁹.

Pas kësaj disfate të osmanëve, Gjergji II Strazimir Balsha duhet të ketë hequr nga vetja sovranitetin formal osman. Në këtë proces rritjeje e fuqizimi të shpejtë të principatës së Balshajve erdhi duke u ngritur doradorës edhe një flotë detare me karakter luftarak e tregtar që u shërbeu për

⁹³ *Burime të zgjedhura ...*, dok. nr. 114, f. 187.

⁹⁴ (Die 5. Septembris). In consilio rogatorum captum per omnes “de recipiendo dominum Georgium Stracimir de Balsa in nostrum civem...”, (*Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 426, f. 103).

⁹⁵ P. Bogdani, *Balshajt - Lufta e Principatës së Balshajve ...*, f. 55.

⁹⁶ Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar (395 – 1875)*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë: 1999, f. 106.

⁹⁷ Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit Fusha politike*, I, Tiranë: Toena, 2000, f. 493.

⁹⁸ *Lufta shqiptaro-turke në shek. XV – Burime Osmane ...*, përg. Selami Pulaha, f. 78, 132-134, 296-297, 312.

⁹⁹ *Po aty*, f. 134.

mbrojtjen dhe zgjerimin e principatës së tyre, që mëtonin të bashkonin troje të gjëra në një shtet të vetëm arbëror, forcimin e lidhjeve dhe shkëmbimeve tregtare brenda e jashtë vendit. Rritja e flotës së Balshajve në detin Adriatik shkaktoi me kohë reagimin e Republikës aristokratike tregtare të Venedikut, e cila e konsideronte detin Adriatik si një gji të mbyllur, për shkëmbime tregtare. Balshajt kishin arritur të krijonin një forcë të konsiderueshme detare që mund të përdorej për shkëmbime tregtare dhe për çështje ushtarake. Venedikasit e kundërshtonin flotën detare të Balshajve. Më 20 korrik 1389, Venediku i ndaloi Gjergjit II Strazimir Balshës që të mbante anije të armatosura¹⁰⁰.

Në qershor të vitit 1389, ushtria e një koalicioni të gjerë të princave ballkanikë u preu rrugën trupave osmane, të prira nga vetë Sulltan Murati I në afërsi të Prishtinës. Në betejën historike të zhvilluar më 28 qershor, morën pjesë mjaft sundimtarë arbërorë si dhe Gjergji II Strazimir Balsha i Shkodrës. Ai mori në betejë një numër të konsiderueshëm ushtarësh. Fitorja u takoi osmanëve të cilët edhe u bënë zotë të trevave arbërore në Kosovë.

Disfata e koalicionit ballkanik kundrejt forcave të Perandorisë Osmane në vitin 1389, në betejën e Fushë Kosovës afër Prishtinës, shënon edhe fillimin e rënies së fuqisë shtetërore të Balshajve në territorin e Kosovës. Ndonëse, Gjergji II Strazimiri ia dilte të kishte sukses në terren kundër Vuk Brankoviçit në vitin 1390 në luftë për qytetin e Ulqinit, si dhe për të marrë Kotorrin pas vdekjes së mbretit boshnjak Tvërtkos (1391), ai nuk ia doli të këtë suksese në ekspeditat sistematike të osmanëve, të cilat u bënë më pushtuese sidomos pas pushtimit të qytetit të Shkupit më 1392, ku në një prej ekspeditave osmane u zu rob vetë Gjergji II Strazimir Balsha. Në këto momente të vështira ai pranoi të hyjë në bisedime me osmanët dhe t'u njohë atyre sundimin mbi krahinën e Shkodrës dhe qyteteve të saj.¹⁰¹ Një vit më vonë, më 1393, Radik Gjuraşi (Cërnojeviçi) i mori Balshës, Budvën. Tashmë, Gjergjit II Strazimir Balshës i mbetën vetëm Ulqini dhe Tivari. Psikoza e pushtimit përfundimtar osman shtyu në atë kohë masa të tëra

¹⁰⁰ *Petitio Georgii Strazimir domini Duleigni "quod possit tenere armatos in mari et in flumariis suis duos brigantinos pro securitate suarum partium et flumariarum pro facto salis", reiicitur, "ne aliqui amici nostri sub pretextu talis concessionis faciant similes requisitiones"*. (*Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 440, f. 106).

¹⁰¹ *Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 485, f. 58.

njerëzish të braktisnin qytetet e Shkodrës, Lezhës, Tivarit e Ulqinit dhe t'i drejtoheshin bregdetit Dalmat.¹⁰²

Tani, përveç rrezikut të depërtimeve të mundshme osmane, dolën në skenë interesat politike pushtuese mjaft të studiuara dhe të parashikuara nga Republika e Venedikut, e cila synonte pushtimin e bregdetit arbëror. Ajo shpejtoi të nxirrte përfitime nga situata e krijuar me qëllim që të vinte dorë mbi qytetet arbërore, para se ato të binin nën pushtimin e osmanëve. Venediku u përpoq që të pushtonte Krujën. Por, venedikasit hasën në rezistencë të vendosur të Balshajve të cilët përmes Konstandin Balshës (djali i Gjergj I Balsha), sundonte në Krujë dhe në territoret përreth si bashkëshort i Helena Topisë.¹⁰³ Konstandin Balsha mbajti një qëndrim të vendosur kundër pushtimit venedikas në vitet 1395-1401 dhe shtriu pushtetin e tij si vasal i sulltanit në një hapësirë të gjerë trojesh arbërore ku përfshihej edhe krahina e Shkodrës.¹⁰⁴ Qyteti i Krujës ishte nën autoritetet e Nikita Topisë deri në vitin 1415. Në vitin 1415 në Krujë u vendos pushteti osman me anë të Ballaban Pashës “Subash i Krujës”.¹⁰⁵ Në kufijtë e Krujës në këtë kohë sundonte e forcohej me të shpejtë Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut.¹⁰⁶ Marrëdhëniet mes Balshajve dhe venedikasve shënuan acarim të theksuar me pushtimin e Lezhës, më 1393.¹⁰⁷ Gjergji II Strazimir Balsha protestoi ashpër në Venedik, duke e quajtur atë një akt armiqësor të shtetit venedikas kundër shtetit të tij. Denoncoi këtë akt pushtues dhe kërkoi largimin e menjëhershëm të venedikasve nga Lezha, duke argumentuar protestën dhe faktin se ky qytet kishte qenë gjithmonë pjesë e pandarë e zotërimeve të familjes së tij. Për ta detyruar Venedikun të tërhiqej nga Lezha, Gjergji II Strazimir Balsha i ndaloi menjëherë shtetasit e tij (ulqinakët, tivarasit etj.) të tregtonin në Lezhë. Në rrethanat që ndodheshin, Balshajt nuk ishin në gjendje të bënin më shumë kundër venedikasve. Por, në ndërkohë osmanët pushtuan Shkodrën, Ulqinin dhe duke zënë rob edhe Gjergjin II Strazimir Balshën. Mirëpo, me ndërhyrjen e Raguzës, Gjergj II Balsha u lirua më 1394. Në këtë situatë të rëndë, i izoluar nga fuqitë huaja dhe nga njerëzit e tij përballë osmanëve, Gjergj II Strazimir Balsha më 3 shkurt

¹⁰² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 304.

¹⁰³ Milan Šufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, Tiranë: 2002, f. 136.

¹⁰⁴ *Po aty*.

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*.

¹⁰⁷ *Po aty*.

1394, u ofron venedikasve Shkodrën e pushtuar nga osmanët.¹⁰⁸ Venediku nuk deshi të implikohet në këtë konflikt, por e inkurajoi në luftën kundër osmanëve për qytetin e Shkodrës, si dhe ia dha të drejtën e qytetarit të Venedikut në maj 1395. Në fillim të shtatorit 1395, Shkodra u morë nga Gjergj II Strazimir Balsha dhe u hoq nga duart e komandantit osman, Shahin.

Meqë situata në principatën e Gjergjit II Strazimir Balsha ishte e vështirë, ai e kuptoi se nuk ishte e lehtë të përballonte trysninë e Perandorisë Osmane, e cila pretendonte t'i pushtonte. Më 14 prill 1396, të plotfuqishmit e Gjergjit II Strazimir Balsha, të cilët më 10 nëntor 1395 i kishte dërguar në Venedik, iu dorëzuan venedikasve qytetin e Shkodrës me rrethina e me portin e Bunës, Shën Gjirgjin, Shasin si dhe qytetin e Drishtit.¹⁰⁹ Për viset e lëshuara ai do të merrte një pension prej 1000 dukatë në vit dhe së bashku me familjen e tij u bënë bujarë të Republikës së Venedikut. Gjergji II Strazimir Balsha u pranua në gjirin e fisnikërisë veneciane dhe të Këshillit të Madh të Republikës. Sipas kësaj marrëveshje, ai mbante për vete dhe për trashëgimtarët e tij Ulqinin dhe distriktin e tij, si dhe qytetin e Tivarit me të gjithë krahinën. Lumi i Bunës mbetej si kufi natyror midis tij dhe Venedikut.¹¹⁰ Në fund, Venediku zotohej të mos i përkrahte kundërshtarët e Gjergjit II Strazimir Balsha, në radhë të parë Radik Gjurashin (Cërnojeviqin), Dukagjinët, Jonimët, Zahariajt, si dhe princin serb Vuk Lazareviçin, me qëllim që ky i fundit të mos i merrte atij atë pjesë të zotërimeve që mbetej nga shteti i mëparshëm i Balshës.¹¹¹

Afrimi me Venedikun nuk e ndaloi Gjergjin II të vazhdonte lidhjet tradicionale me kundërshtarët e Venedikut, me Republikën e Raguzës dhe Mbretërinë e Hungarisë. Gjatë qëndrimit të Gjergji II Strazimir Balsha në Raguzë më 21-28 dhjetor 1396, Mbreti hungarez Sigismundi, e takoi atë dhe e quajti princ arbëror "*princeps Albanie*"¹¹². Gjithashtu e

¹⁰⁸ *Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 513, f. 133.

¹⁰⁹ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, (Tiranë: 2002), f. 136; *Acta et Diplomata*, II, dok. nr. 555, f. 148.

¹¹⁰ Luan Malltezi, "Shkaqet e luftës së Balshës III Kundër Venedikut në 20 vjetët e para të shekullit XV", në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, vëll. III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1989, f. 181-182.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, (Tiranë: 2002), f. 227; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 306.

emëroi zhupan të vetin në Korçula dhe në Hvar. Këtë nderim ai e mbajti deri në fund të jetës së tij. Gjergji II Balsha u mundua deri në fund të ruante një farë distance nga osmanët. Ndryshe nga mjaft fisnikë arbër dhe shumë të tjerë ballkanikë, ai nuk shkoi të ndihmonte sulltan Bajazitin në betejën e Ankarasë kundër mongolëve të Timurlengut. Gjergji II Strazimir Balsha vdiq aty nga fillimi i vitit 1403 në qytetin e Ulqinit.¹¹³

Administratorët venedikas morën pa kundërshtim qytetet e Shkodrës dhe Drishtin. Kurse qytetet e vogla mbi lumin Drin, Danja dhe Shasi nuk pranuan t'u dorëzohen autoriteteve venedikase në asnjë mënyrë.¹¹⁴ “Këto vende, mbi të cilat në vitin 1395 sundonte Konstandin Balsha, nuk dëgjoi t'i dorëzonte kështjellari i tij, shqiptari Kojë Zaharia”.¹¹⁵ Por, siç dihet Boja, e bija e Kojë Zaharisë, ua dorëzoi venedikasve këto qytete më 1444. Më vonë, Lidhja Shqiptare e udhëhequr nga Skënderbeu ua mori prapë venedikasve Danjën. Por, më vonë venedikasit e morën prapë Danjën në saje të marrëveshjes së vitit 1448 me Skënderbeun dhe më vonë (1456-1458) me Dukagjinët.¹¹⁶

Në krye të udhëheqjes se shtetit të Balshajve, pas vdekjes së Gjergjit II Strazimir Balsha, u vu i biri i tij, Balsha III (1403 - 1421). Ky udhëheqës i ri dhe shumë guximtar i cili ishte edhe trashëgimtari i fundit i Dinastisë së Balshajve, filloi luftën e papajtueshme kundër venedikasve për trashëgiminë e familjes së tij.¹¹⁷ Në tetorin e vitit 1404, Shkodra dhe Drishti u morën me sulme nga Balsha III. Por, venedikasit ndërmorën masa të menjëhershme. Ata u morën vesh me Sulltan Bajazitin e osmanëve, dhe me Brakoviqin e Lazarin serb, që të jenë neutralë, në ndërmarrjen e tyre në Shqipërinë e Veriut. Në anën e venedikasve kaloi edhe Kojë Zaharija.¹¹⁸ Në këtë mënyrë, kundërmësymja e Venedikut në korrik 1405 rikthyen prapë Shkodrën, Drishtin, Ulqinin, Tivarin dhe Budvën etj.¹¹⁹

Megjithatë venedikasit duke parë fuqinë dhe rolin e Balshës III në trevat e veta, i ofruan atij të lidhnin paqe. Me ndërmjetësimin e Niketë Topisë, vjehrrit të Balshës, paqja u nënshkrua në qershor 1408 në Kishën

¹¹³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 306.

¹¹⁴ M. Šufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, (Tiranë: 2002), f. 136.

¹¹⁵ *Po aty*.

¹¹⁶ *Po aty*.

¹¹⁷ *Po aty*, f. 137.

¹¹⁸ *Po aty*.

¹¹⁹ *Po aty*.

e Shën Laurentit, jashtë mureve të Durrësit. Me këtë paqe Venediku pranoi t'ia kthente Balshës III, Budvën dhe Lushticën, si dhe t'i jepte atij një provizion vjetor prej 1500 dukatësh. Venedikut iu njoh e drejta e sundimit në Tivar dhe në Ulqin. Çështja e Tejbunës u la e hapur. Të dyja palët u morën vesh të bënin një amnisti të përgjithshme dhe t'i shkëmbenin robërit e luftës.¹²⁰ Marrëveshja duhej të implementohej brenda 15 ditësh. Sipas kërkesës së Balshës III dhe të Helenës marrëveshja do të garantohej nga Niketë Topia, Gjon Kastrioti, Teodori III Muzaka i Beratit dhe Merksha Zharkoviq i Vlorës etj.¹²¹

Por, pas disa vitesh Balsha III u forcua dukshëm. Më 1409, në kohën kur Venediku ishte në luftë me Mbretin hungarez Zigismundin, Balsha III përfitoi nga rasti dhe pushtoi Tivarin. Ai vazhdoi përpjekjet për të rikthyer territoret e tij. Më 1418, arriti të rikthej Drishtin. Në fund të vitit 1420, Balsha III sulmoi Kotorrin, që kishte pranuar sundimin e Venedikut. Në betejën e zhvilluar në janar të vitit 1420 jashtë mureve të qytetit të Kotorrit, ushtria e Balshës u thye keqas.¹²² Disa muaj më vonë pinjulli i fundit i Balshajve vdiq duke mos lënë pasardhës (26 prill 1421) pa mundur të rikrijonte zotërimet e pavarura të paraardhësve të tij të mëdhenj.¹²³

S u m m a r y

KOSOVO AS PART OF THE BALSHAJ PRINCIPALITY

The Baljash Principality was created in 1360s and lasted till 1421. The overlords Balshaj brothers (Strazimir, Gjergj and Balsha II) in 1360 ruled over the territory of Zeta that included Ulqin, Tivar, and Shkodra which became its center. In the Middle Ages the territory of Zeta was considered a region of Arbëria. With regard to this family's origin are held various opinions. The

¹²⁰ *Po aty*.

¹²¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2002), f. 306.

¹²² *Po aty*, f. 307.

¹²³ *Po aty*.

Hungarian King Sigismund, when he met personally in 1396 with one of these overlords, called him “ruler of Arbëria”.

After the battle of Marica (26 September 1371) and the fall of the Nemanjid dynasty, once the Serbian emperor Urosh V died, (4 December 1371) the political fate of Kosovo and other Albanian territories in the south, from Ohër to Kostur remained in the hands of native local authorities.

The Balshaj Principality reached the height of its economic development and political stability especially during Balsha II (1379-1385). In the 1380s Balsha II managed to include the greater part of the territory of Kosovo within its principality.

The strengthening of Balshaj was considered a danger for the Venetian Republic’s interests in Albanian territories. Moreover, The Balshaj aims to expand the territory of their principality led to conflicts with other Albanian overlords such as Dukagjini and Topia.

In 1385, the Balshaj Principality was attacked jointly by the Ottomans and Karl Topia. In the battle taking place in Sarva, Balsha II was killed. This was a serious blow that weakened the foundations of the unified Balshaj principality. Therefore, the principality was divided in three parts. The most of Balshaj possessions preserved were in the north, in Zete and the towns of Shkodra and Drishti, under Gjergj II Strazimir Balsha who ruled the principality from 1385 to 1403. The territory of Kosovo in its greater part fell under Slavs’ rule, as the later had become vassals of the sultan, while another part, from Lezha to Peja, fell to the local rulers, Dukagjini who had also recognized the sultan as their overlord.

In June 1389, in the Battle of Kosovo, the Ottoman alliance won against the Balkan alliance in which Gjergj II Strazimir Balsha had been part of. In 1395 he found himself in a very difficult situation due to Ottoman pressure and consequently handed to the Venetian Republic the towns of Shkodra, Shasi, Drishti. However, he continued to rule the towns of Ulqini and Tivari.

